

VENDIMI ËSHTË I PLOTFUQISHËM  
ODLUKA JE PRAVNOSNAŽNA  
GJYKATA THEMELORE / OSNOVNI SUD  
FERIZAJ I UROŠEVAC

NË EMËR TË POPULLIT

Më  
Dana

10.06.2016

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ – Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal**, si gjykatë e shkallës së parë penale, në përbërje nga gjyqtarja individuale Hakile Ilazi, sekretarja juridike Violeta Zeqiri, në lëndën penale kundër të akuzuarit [REDACTED], për shkak të veprës penale vjedhja e shërbimeve komunale nga nen 320 par.1 të KPRK-së, sipas propozim akuzës të Prokuroria Komunale në Ferizaj PP/II.nr.2077-4/14 të datës 15.09.2015, pas mbajtjes së shqyrtimit Fillestar me datë 22.04.2016 në prezencë të Prokurorit të Shtetit Burim Qerkini dhe të akuzuarit shpall dhe publikisht komunikon, ndërsa perpilimi me shkrim bëhet me datën 29.04.2016 mori këtë:

#### A K T G J Y K I M

I akuzuari [REDACTED], nga [REDACTED] rruga [REDACTED], i lindur me [REDACTED], me nr. personal [REDACTED], nga i ati [REDACTED] dhe e ëma [REDACTED] e gjinisë [REDACTED], i pa martuar, i gjendjes së dobët ekonomike, i pa punësuar, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

#### Është fajtorë

Se në kohë të papërcaktuar e deri më datë 29.07.2014 në shtëpinë e tij në rrugën “Rizah Matoshi” ne Ferizaj, gjatë kontrollit të njehsorit elektrik me nr.45871607 nga ana e punëtorëve të KEDS-it Distriktit në Ferizaj, është konstatuar se është furnizuar me energji elektrike, në atë mënyrë që konsumatori ka liruar dhe larguar tri urat e tensionit ku energjia elektrike e shpenzuar fare nuk është regjistruar, me të cilin veprim ka dëmtuar KEDS Distriktin në Ferizaj në shumë prej 170,38€.

me të cilën ka kryer veprën penale vjedhja e shërbimeve komunale nga nen 320 par.1 të KPRK-së.

Andaj gjykata ne baze të neneve 4,6,17,21,41,46,51 dhe 73 të KPRK-së si dhe neni 365 të KPPK-së, shqipton:

#### Dënim me kusht

**DËNIM ME BURGIM NË KOHËZGJATJE PREJ 2/dy/ dhe dënim me gjobë në lartësi prej 200 / dyqind / euro të cilat dënime nuk do të ekzekutohen në rast se i akuzuari brenda 1/një/viti nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nuk kryen vepër tjetër penale (koha e verifikimit)**

Obligohet i akuzuari që të dëmtuarës [REDAKTUAR] t'i paguaj shumën në vlerë prej 170,38 (njëqind e shtatëdhjetë euro e tridhjetë e tetë cent ) €, në emër të dëmit të shkaktuar, nën kërcënim të përmbarimit me dhunë.

Gjithashtu obligohet i akuzuari në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 25 /njëzetë e pesë /€ në afat prej 30 ditësh.

#### Arsyetimi

Prokuroria Themelore në Ferizaj, me aktakuzë PP/II.nr.2077-4/14 të datës 15.09.2015, ka akuzuar [REDAKTUAR] për veprën penale vjedhja e shërbimeve komunale nga neni 320 par.1 të KPRK-së.

Gjykata duke vepruar sipas kësaj akuze caktoi dhe mbajti shqyrtimin fillestar me datë 22.04.2016, në të cilën shqyrtim i akuzuari është deklaruar fajtor për veprën për të cilën e ngarkon akuza, duke e shprehur pendim dhe real për veprën e kryer lut gjykatën që t'i shqiptoj një dënim sa me te butë.

Pasi që i akuzuari ka pranuar fajësinë, Gjykata për të vlerësuar pranimin e fajësisë dhe shqyrtoi me kujdes faktet e parapara nga neni 248 par. 1 të KPPK-së dhe me këtë rast vlerësoi se i akuzuari ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajit, pranimi është bërë vullnetarisht nga ana e të akuzuarit, pranimi i fajit mbështet në faktet dhe prova materiale të rastit konkret dhe atë me provat e paraqitura nga Prokurori i Shtetit dhe atë: kallëzimin penal KEDS-it departamenti ligjor në Ferizaj me Nr. CMS-K/DFE 940 të datës 27.08.2014 procesverbali me nr.1565404 i datës 29.07.2014, fatura e datës 31.07.2014.

Meqenëse i akuzuari ka pranuar fajësinë e cila është në përputhje me kriteret e përshkruara më lartë, andaj gjykata konform nenit 248 paragrafit 4 të KPPK-së, ka vlerësuar se nuk është e nevojshme vërtetimi i ndonjë fakti relevant për shqiptimin e dënimit dhe për këtë arsye ka vazhduar me shqiptimin e dënimit.

Duke vlerësuar në aspektin juridik gjykata gjeti se në veprimet e të akuzuarit ekzistojnë të gjitha tiparet objektive dhe subjektive të veprës penale vjedhja e shërbimeve komunale nga neni 320 par.1 të KPRK-së.

Me rastin e matjes së llojit dhe lartësisë së dënimit për të akuzuarin, Gjykata vlerësoj rrethanat në kuptim të nenit 73 të KPRK-ës dhe gjeti si rrethanë veçanërisht lehtësuese se e akuzuara ka pranuar fajësinë, duke e shprehur pendimin e sinqertë dhe real për veprën penale të kryer, gjendja e varfër ekonomike, sjelljen korrekte gjatë tërë procedurës, si dhe në shqyrtimin fillestar, në rastin konkret nuk gjeti ndonjë rrethanë rënduese, vetë pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarës dhe rrethanat në të cilën ka ndodhur ngjarja, përveç që vlerësoj shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarit si dhe rrezikshmërinë konkrete të veprës penale.

Gjykata është bindur se dënimi i shqiptuar ndaj të akuzuarit është në harmoni me peshën e veprës penale, me shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarës dhe me dënimin e shqiptuar me kusht do të arrihet qëllimi i dënimit siç parashihet ne dispozitat e nenit 41 të KPRK-së.

Obligohet i akuzuari që të dëmtuarës [REDAKTUAR] t'i paguaj shumën në vlerë prej 170,38 (njëqind e shtatëdhjetë euro e tridhjetë e tetë cent ) €, në emër të dëmit të shkaktuar, nën kërcënim të përmbarrimit me dhunë.

Konform nenit 450 dhe 451 të KPPK-së, obligohet i akuzuari në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 25 /njëzetë e pesë /€ në afat prej 30 ditësh.

Nga arsyet e sipër cekura është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

### **GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ**


**P.nr.1094/15 me datë 29.04.2016**

**Sekretare Juridike**

Violeta Zeqiri

**Gjyqtarja Individuale,**

Hakile ILAZI



**Këshilla juridike:** kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa Gjykatës së Apelit në Prishtinë, në afat prej 15/pesëmbëdhjete/ditësh. Kurse i dëmtuari mund të paraqet ankesë vetëm sa i përket vendimit për sanksionin penal nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, përmes kësaj gjykate.